



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 7.11. 2019

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KOMISIONIN NDËRKOMBËTAR PËR EKSPLORIMIN SHKENCOR NË DETIN MESDHE”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 7.11.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Adnor Shameti.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishte i pranishëm z. Blendi Klosi, ministër i Turizmit dhe Mjedisit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar synon aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe, si një nga shtetet që laget nga Deti Mesdhe, për të kryer hulumtime, studime dhe punë oqeanologjike në këtë det.

Projektligji ka si qëllim që të kontribuojë në zbulimin dhe mbrojtjen e Detit Mesdhe dhe deteve që kontribuojnë në këtë det.

Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe është një organizatë ndërqeveritare me seli në Monako, e cila përbëhet nga 23 shtete anëtare e konkretisht: Algjeria, Kroacia, Qipro, Egjipti, Franca, Gjermania, Greqia, Izraeli, Italia, Libani, Malta, Maroku, Monaku, Portugalia, Rumania, Rusia, Sllovenia, Spanja, Zvicra, Siria, Tunizia, Turqia dhe Ukraina. Këto shtete mbështesin një rrjet me disa mijëra studiues detarë që përdorin mjetet më të fundit shkencore për të kuptuar, monitoruar dhe mbrojtur më mirë Detin Mesdhe i cili po ndryshon në mënyrë të shpejtë dhe të pashembullt. Është pikërisht Komisioni që gjurmon dhe analizon këto ndryshime, të cilat vijnë nga ndikimi i ngrohjes globale në nivelin e detit dhe masat ujore deri te ndryshimet në biodiversitetin detar.

Duke qenë se Deti Mesdhe është një trashëgimi shekullore, shtetet kanë si objektiv të mundësojnë shkëmbimin e standardeve dhe ideve shkencore, por edhe të mbajnë një dialog konstruktiv e paqësor midis tyre, pasi për një kohë të gjatë ato kanë qenë të ndarë nga konfliktet historike.

Miratimi i teknologjive të reja do t'u mundësojë vendeve palë të fitojnë avantazhe konkurruese në treg, pasi shumë prej teknologjive alternative të zhvilluara së fundi kanë si efekt direkt rritjen e efikasitetit të energjisë dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve.

Duke qenë pjesë e këtij projekti, Republika e Shqipërisë do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare, nëpërmjet projekteve të vogla dhe të mesme, për të mbrojtur dhe për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë.

Shtetet nënshkruese, me anëtarësimin në këtë komision, angazhohen për të derdhur një kontribut vjetor prej 25 000 eurosh, për një periudhë pesëvjeçare. Anëtarësia ripërtërihet me periudha pesëvjeçare.

Çdo shtet nënshkrues gëzon vetëm një të drejtë vote. E drejta e votës ushtrohet nga i deleguari, të cilit i është caktuar kjo e drejtë nga shteti.

III. DISKUTIME NË KOMISION

Z. Blendi Klosi, Ministër i Turizmit dhe Mjedisit pasi bëri një prezantim të projektligjit, iu përgjigj pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

Në përgjigje të pyetjeve të anëtares së komisionit, znj. Klotilda Bushka, nëse është i nevojshëm ndryshimi i kuadrit ligjor për ta bërë të zbatueshëm projektligjin dhe se cilët janë përfituesit e ndihmës ekonomike dhe teknike, z. Klosi sqaroi se:

Në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshje, nuk është i nevojshëm ndryshimi i kuadrit ligjor, por rregullimi i fushës së turizmit detar dhe filozofisë për ta zgjeruar atë, sjell domosdoshmërisht nevojën për ligje të reja dhe ndryshime në disa prej ligjeve që janë në fuqi e që e normojnë këtë fushë.

Lidhur me përfitimet financiare dhe kategorinë e përfituesve nga anëtarësimi në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe, z. Klosi u bëri të ditur anëtarëve se aktualisht po zbatohen dy projekte të rëndësishme të financuara nga Komisioni Ndërkombëtar, nën kujdesin e veçantë të princit Albert II i Monakos. Njëri prej projekteve mbështet zonat e mbrojtura, konkretisht parkun kombëtar të Karaburunit, me qëllim forcimin e kapaciteteve tona administrative për ta bërë parkun kombëtar një atraksion të fuqishëm turistik e më të aksesueshëm për turizmin. Përfitues të ndihmës janë edhe shoqatat. Konkretisht projekti i dytë ka të bëjë me mbështetjen e dhënë për shoqatën “Pisha Flamur” për studime shkencore lidhur me mbrojtjen e një nga monumenteve të rëndësishme të trashëgimisë tonë natyrore që është Pisha Flamur në zonën e Karaburunit.

Anëtari zëvendësues i komisionit, z. Ralf Gjoni pasi përgëzoi ministrin për nismën ligjore të propozuar, parashtrroi pyetjen nëse vendi ynë ka kapacitetet e duhura shkencore për të siguruar hulumtimin, studimin apo punën oqeanologjike në Detin Mesdhe. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, ministri siguroi se vendi ynë i ka të gjitha kapacitetet shkencore për të konkuruar me vendet e tjera anëtare të këtij komisioni ndërkombëtar.

Duke ju referuar relacionit të projektligjit, anëtarja e komisionit, znj. Vasilika Hysi kërkoi informacion nëse ministria, në kuadër të aderimit të Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar, ka nisur punën për koordinimin e bashkëpunimit me të gjithë aktorët, konkretisht me universitetet që në profilin e tyre kanë kërkimin shkencor, si dhe shoqatat dhe agjencitë përfituese.

Z. Klosi informoi anëtarët e komisionit lidhur me bashkëpunimin dhe konsultimet e vazhdueshme të ministrisë me universitetet dhe shoqatat e mjedisit. Ministria ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Shkencave Natyrore, Fakultetin e Inxhinierisë së Mjedisit dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Në përfundim të diskutimeve, relatori, z. Adnor Shameti, ftoi të gjithë anëtarët e komisionit që ta votojnë projektligjin.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat shumicës së anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

ADNOR SHAMETI

KRYETAR

ULSI MANJA